

**HALLKA E TRIDHJETË E TRETË DHE E  
FUNDIT E ZINXHIRIT TË MURSHIDËVE**

---

**SULEJMAN HILMI  
TUNAHAN (K.S.)**



*Botim i Fazilet Neşriyat / 234*

**HALLKA E TRIDHJETË E TRETË DHE E  
FUNDIT E ZINXHIRIT TË MURSHIDËVE**

**SULEJMAN HILMI TUNAHAN (K.S.)**

**Përgatiti**

Fazilet Neşriyat Araştırma Heyeti

**Grafika / Dizajni**

Çamlıca Grafik Servisi

**Printimi dhe Faqosja**

Çamlıca Basım Yayın ve Tic. A.Ş.

Numri i Botimit: 46592



**FAZİLET**  
NEŞRİYAT

**ISBN**

978-625-8027-31-0

**Botimi**

İstanbul, 2024

**Kontakt**

Bağlar Mah. Mimar Sinan Cad.

No: 54 Güneşli - Bağcılar / İSTANBUL

Tel: 0212 657 88 00

[www.fazilet.com.tr](http://www.fazilet.com.tr)

[bilgi@fazilet.com.tr](mailto:bilgi@fazilet.com.tr)

*© Të gjitha të drejtat e kësaj vepre janë të rezervuara në emër të Çamlıca Basım Yayın ve Tic. A.Ş. Fazilet Neşriyat është një markë e Çamlıca Basım Yayın ve Tic. A.Ş.*



حلمه

۱۳۹۷



*Ebu'l-Fâruk Sulejman Hilmi TUNAHAN (K.S.) (SİLİSTREVÎ) (1888-1959)*



## **Hallka e Tridhjetë e Tretë dhe e Fundit e Zinxhirit të Murshidëve**

**SULEJMAN HILMI TUNAHAN (K.S.)**

Sulejman Hilmi Tunahani ka lindur në fshatin Ferhatllar të komunës Hazergrad në zonën e Silistres e cila sot ndodhet në Bullgari, në vitin 1304 Rumi (1305 Hixhri, 1888 Miladi). Babai i tij është Hoxha Zade Osman Efendiu i cili ka mbaruar studimet në Stamboll dhe më pas për vite të tëra ka kryer detyrën e Myderrizit (mësuesit) në Medresenë Satirli në Silistre. Emri i nënës së tij është Hatixhe Hanëm. Ndërsa gjyshi i tij është Mahmud Efendiu i cili është i njohur me nofkën Kajmak Hafiz. Gjyshi i tij ka ndërruar jetë në moshën 110 vjeçe.

Kjo familje e njohur me hoxhallarët e saj të trashëguar, mbështetet në rrënjët e Idris Beut. Idris Beu është emëruar nga Fatih Sulltan Mehmeti përgjegjës në zonën e bregut të Lumit Tuna dhe i ka dhënë motrën e vet për grua.

Hz. Sulejman Efendiu (k.s.) njësoj si babai i tij, përdorte pseudonimin Hoxhazade, më pas me ligjin e mbiemrit mori mbiemrin “Tunahan”, ai njihej dhe me

pseudonimin “Ebu’l-Faruk” për shkak të djalit të tij që quhej Faruk, i cili vdiq në moshë të re.

Babai i tij Osman Efendiu kur ishte me studime në Stamboll shikon një ëndërr të rëndësishme që të tërhiqte vëmëndjen. Në ëndërr shikon sikur i këputet një copë drite nga trupi i tij, ngrihet lart në qiell dhe shpërndahet në të gjithë botën. Ai këtë ëndërr e komenton duke thënë se nga familja e tij do të vijë një fëmijë që do të ndriçojë gjithë botën.

Kur kthehet në Silistre martohet. Nga kjo martesë lindin Fehimi, Sulejman Hilmiu, Ibrahimimi dhe Halili. Osman Efendiu e kupton se drita që ka parë në ëndërr është Sulejman Hilmiu. Ai kujdeset në mënyrë të veçantë për edukimin dhe arsimimin e Sulejman Hilmiut.

## **Studimi në Stamboll**

Hazreti Sulejman Efendiu (k.s.) studimet e para i ka kryer në vitin 1902 në Medresenë e Rushdijes të Silistres. Në të njëjtin vit, ai filloi studimet në Medresenë Satirli në Silistra, ku studioi shkencat bazë arabe. Pastaj për të plotësuar studimet dërgohet në Stamboll nga i ati i tij. Në kohën kur e dërgon për në Stamboll i ati i jep një këshillë:

**“ Biri im! Nëse mëson mirë Usuli Fikhun (Metodologjinë e Jurisprudencës Islame) në fe bëhesh i fortë, nëse mëson mirë ilmin e Mantëkut (shkencat llogjike) në dituri bëhesh i fortë.”**

Hazreti Sulejman Efendiu (k.s.) vazhdon ligjëratat e Ahmed Hamdi Efendiut nga Bafra, një nga ligjëruesit e

Fatihut dhe një nga dijetarët e famshëm të periudhës, në Stamboll. Gjatë këtyre viteve, ai banoi në Medresenë Hafız Ahmed Pashë, po ashtu në Fatih. Ai jep mësim në Bahr-i Sefîd Çifte Baş Kursunlu, një nga Medresetë Fâtih (Sahn-ı Semân). Të gjitha mësimet i kreu nga Ahmed Hamdi Efendi dhe e mori licencën në vitin 1913 me gradën e parë.

Ai u regjistrua në Departamentin e Medresesë Dârü'l-Hilâfeti'l-Aliyye, ku filloi arsimin në tetor 1914 (Teşrinievvel 1330), kaloi klasën e parë dhe të dytë me provim dhe filloi studimet nga klasa e tretë.

U diplomua në vitin 1916 (shtator 1332) (Emri i katërvjeçarit Kısım-ı Âlî që vepronte në Medresetë Fâtih në klasën e tretë dhe të katërt u ndryshua në Sahn në vitin 1917.)

Në 30 shtator 1916 u regjistrua në degën e Tefsirit dhe Hadithit të Medresetu'l-Mutehassisin, ku studioi për tre vjet, me qëllim specializimin (doktoraturën). (Emri i Medresesë Mutehassisin, e cila funksiononte në Medresenë Abdulhamid-i Evvel pranë Xhamisë Yavuz Sultan Selim në Fatih, u ndryshua në “Medreseja Sulejmanije” në vitin 1917.)

Pasi i përfundoi me sukses dy vitet e para, në vitin 1918 (1334), së bashku me njëzet shokë të tijë, iu dha pozita e profesorit të Stambollit me kërkesën e pozitës së Sheikh-ul-Islamit dhe testamentin e Sulltan Mehmed Vahiduddin Hanit dhe kështu ata u bënë pedagogë. Hz. Sulejman Efendiu (k.s.) u diplomua në degën e Tefsir dhe Hadith të Medresesë Sulejmanije (Medresetu'l-Mutehassisin) me gradën e parë më 27 maj 1919.



Pasi mbaroj studimet në Medresenë Mutehassisin ai kishte fituar provimin me pikët më të larta për të hyrë në Medresetul Kuzat (Fakulteti i Juridikut). Ai këtë lumturi e ndan me babain e tij me anë të një letre që i dërgon, por nga Babai ai merr një telegraf të tillë:

**“ Sulejman! Unë nuk të kam dërguar në Stamboll për të shkuar në xhehennem.”**

Babai me anë të këtij telegrafi po i kujtonte hadithin e Pejgamberit a.s ku thotë: “ Nga tre gjykatës dy do të jenë në xhehennem.”\*

Në përgjigjen e tij drejtuar babait të tij, hz. Sulejman Efendiu (k.s.) tha se “Ai kurrë nuk kishte ndërmend të ndiqte profesionin e të qenit gjyqtar (gjykatës), qëllimi i tij ishte të arrinte përsosmërinë në fushën e të gjitha shkencave fetare ekzotrike të kohës së tij”. Ai mori diplomën e tij nga departamenti i Tefsirit dhe Hadithit të Medrese-i Süleymaniye. Ai jo vetëm u arsimua dhe u bë mësues, por u diplomua edhe në Medresetü'l-Kuzât (1923), i cili kishte një arsim 4-vjeçar dhe mori gradën kadi. Kështu, ai arriti shkallën më të lartë në shkencat racionale dhe fetare të kohës së tij.

**Hz. Sulejman Efendiu (k.s.) studioi edhe astronominë.**

Lëndët që ka studiuar në Daru'l-Hilafeti'l-Alijje Medrese Kısım-ı Ali Klasa e Tretë dhe notat e tyre janë si më poshtë:

- Tefsir-i Sherif: 10
- Hadith: 10

---

\* Sunen-i Tirmizi.